



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 11.10.2012
Nr. 0004-1099

PËR: Burim Berisha, Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës
Jakup Tërrnava, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës,

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS NR 138, 139, 140, 141, të pranuar më datën 09.10.2012.

Të nderuar/a


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit. Nr. 138, 139, 140, 141, të miratuar me datë 24/09/2012 nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e akteve, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Aktet juridike të listuara të cilat prodhojnë efekt të plotë juridik:


- Vendimi Nr. 138, Aprovohet propozimi për ndërrimin e emërimit të rrugës në qytetin e Fushë-Kosovës nga "Lekë Dukagjini" në "Silifke"- qytet i Turqisë;
- Vendimi Nr. 139, Për formimin e grupit punues për bisedime me z. Valdet Shaqiri, blerës i ndërtesës së Komunës së Fushë-Kosovës në rrugën "Nënë Tereza" nga Agjencia Kosovare e Privatizimit;
- Vendimi Nr. 140, Për refuzimin e kërkesës së palës Mehmet (Pajazit) Lajçi, me Nr. 02-1-2977, e datës 16.05.2012 për dhënien e pëlqimit për servitut sendor;
- Vendimi Nr. 141, Për refuzimin e propozimit Nr. 317 të datës 18.09.2012, lidhur me kërkesën e palës Xhafer Bërbatovci me Nr. 1182, për dhënien në shfrytëzim të pronë së paluajtshme komunale.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,



Kopje: *Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së*
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 11.10.2012

Br. 0004-1099

Za: Burim Berisha, Gradonačelnik Opštine Kosovo Polje
Jakup Tërrnava, Predsedavajući Skupštine Opštine-Kosovo Polje,

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKA SKUPŠTINE OPŠTINE KOSOVO POLJE BR. 138, 139, 140, 141, primljene dana 09.10.2012.

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenog po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040 ,Zakonom Br. 03/L-049 O Finansijama lokalne samouprave , dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br. 138, 139, 140, 141, usvojene dana 24/09/2012 od Skupštine Opštine-Kosovo Polje, **POTVRDJUJE** zakonitost akata, i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Navedena pravna Akta koji proizvode pune pravne efekte :


- Odluka br. 138, Usvaja se predlog za promenu imena ulice u gradu Kosovo Polje "Lekë Dukagjini" na "Silifke"- grad u Turskoj;
- Odluka br. 139, za formiranje radhe grupe za razgovore sa g. Valdet Shaqiri, kupac zgrade Opštine Kosovo Polje u ulici "Nënë Tereza" od Kosovske Agencije za Privatizaciju;
- Odluka br. 140, o odbijanju zahteva stranke Mehmet (Pajazit) Lajçi, sa br. 02-1-2977, od dana 16.05.2012 i davanja saglasnosti za korišćenje nečije imovine;
- Odluka br. 141, o odbijanju predloga br. 317 od dana 18.09.2012, u vezi sa zahtevom stranke Xhafer Bërbatovci sa br. 1182, za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS,



Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a*
Direktorima uprava i kancelarija
hivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 24.09.2012


Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2012, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 127, të datës 18.09.2012, paraqitur nga Drejtoria për Shërbime Publike, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40.2, shkronja (i), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (gj), të Statutit të Komunës, Nr. 56, i datës 29.04.2010, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për ndërrimin e emërimit të rrugës në qytetin e Fushë-Kosovës nga "Lekë Dugagjini" në "Silifke" – qytet i Turqisë.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për SHP, Drejtorisë për FEZH dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Jakup Tërnavë





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 24.09.2012


Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2012, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 128, të datës 18.09.2012, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 56, i datës 29.04.2010, mori:

V E N D I M

- I. Për formimin e Grupit Punues për Bisedime me z. Valdet Shaqiri, blerës i ndërtesës së Komunës së Fushë-Kosovës, me adresë në rrugën "Nënë Tereza" Pn. në Fushë-Kosovë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në përbërje:
 1. Ibush Kelmendi - anëtar i Kuvendit të Komunës, Kryetar i Grupit Punues;
 2. Arsim Tërnavë - anëtar i Kuvendit të Komunës;
 3. Shaban Ademi - anëtar i Kuvendit të Komunës;
 4. Bahrije Hasolli - anëtare nga Ekzekutivi i Komunës dhe
 5. Mobere Pllana - anëtare nga Ekzekutivi i Komunës.
- II. Detyrë e Grupit Punues është arritja e marrëveshjes për vazhdimin e qëndrimit të personelit të Administratës së Komunës së Fushë-Kosovës, në objektin e privatizuar, deri në kalimin në objekt të ri të Komunës, që është në ndërtim nga donatori - Komisioni Evropian.
- III. Për punën e tij Grupi Punues i raporton me shkrim Kuvendit të Komunës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqë, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për PUKMM, Drejtorisë për FEZH dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Jakup Tërnavë





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 24.09.2012


Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2012, pas shqyrtimit të kërkesës së palës, Mehmet (Pajazit) Lajçi, me Nr. 02-1-2977, e datës 16.05.2012 për dhënien e pëlqimit për servitut sendor në Ngastrën Kadastrale Nr. 00195-2, në sipërfaqe prej $S=222m^2$, bazuar në nenin 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr. 03/L-226 (Gazeta Zyrtare Nr. 89/2010), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 56, i datës 29.04.2010, mori:

V E N D I M

- I. Për refuzimin e kërkesës së palës, Mehmet (Pajazit) Lajçi, me Nr. 02-1-2977, e datës 16.05.2012 për dhënien e pëlqimit për servitut sendor, në Ngastrën Kadastrale Nr. 00195-2, në sipërfaqe prej $S=222 m^2$, pronë e Komunës, për të realizuar të drejtën e kalimit në pronat e tij private në Ngastrat Kadastrale me Nr. 00192-1, 00193-1, 00193-2, 00194-1, 00194-2 dhe 00194-2 në vendin e quajtur "Kijuç Kijuç", të evidentuara në Fletën Poseduese UL-72514011-00123, në Zonën Kadastrale Vragoli.
- II. Të drejtën e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-226, Komuna e ka vetëm në rastet kur ka interes publik nga dhënia në shfrytëzim dhe realizon të ardhura publike komunale.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për PUKMM, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Jakup Tërnavë





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 24.09.2012

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.09.2012, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 317, të datës 18.09.2012, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Nr. 01385-0, në sipërfaqe prej $S=92m^2$, bazuar në nenin 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr. 03/L-226 (Gazeta Zyrtare Nr. 89/2010), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 56, i datës 29.04.2010, mori:

V E N D I M

- I. Për refuzimin e propozimit Nr. 317, të datës 18.09.2012, lidhur me kërkesën e palës Xhafer Bërbatovci, me Nr. 1182, e datës 28.10.2010, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, në Ngastrën Kadastrale Nr. 01385 - 0, në sipërfaqe prej $S=92 m^2$, në vendin e quajtur "Kënetë", e evidentuar në Fletën Poseduese UL-72514036-01555, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.
- II. Të drejtën e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-226, Komuna e ka vetëm në rastet kur ka interes publik nga dhënia në shfrytëzim dhe realizon të ardhura publike komunale.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për PUKMM, Palës dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Jakup Tërnavë**

